

# **UDHËZUES PËR ZHVILLIMIN E KURRIKULËS SË RE NË AMU (KLASAT VI-IX)**

**MATERIAL NDIHMËS PËR MËSUESIT DHE DREJTUESIT  
E SHKOLLAVE**

## **Përmbajtja**

1. HYRJE.....	2
2. PLANI MËSIMOR PËR ARSIMIN E MESËM TË ULËT (AMU) .....	2
3. PLANIFIKIMI I MËSIMDHËNIES .....	3
<b>Llojet e planifikimeve</b> .....	4
<b>Planifikimi vjetor i lëndës</b> .....	4
<b>Planifikimi sipas periudhave</b> .....	6
<b>Planifikimi ditor</b> .....	8
4. VLERËSIMI I NXËNËSIT .....	13
<b>Vlerësimi i vazhduar</b> .....	13
<b>Vlerësimi me test ose detyrë përmbledhëse</b> .....	15
<b>Vlerësimi me portofol lëndor</b> .....	15
<b>Vlerësimi periodik</b> .....	18
<b>Vlerësimi përfundimtar</b> .....	18
<b>Vlerësimi i nxënësit për zhvillimin e kompetencave kyçe</b> .....	20
SHTOJCË 1: Formate planifikimi.....	22
SHTOJCË 2: Modele evidencash .....	24
<b>Kujtesë</b> .....	25

## 1. HYRJE

Udhëzuesi për zhvillimin e kurrikulës së re në AMU synon t'u vijë në ndihmë mësuesve, dhe drejtuesve të shkollave. Gjithashtu, udhëzuesi mund t'u shërbejë prindërve për qëllime informimi, si dhe specialistëve të arsimit për të monitoruar ose për të mbështetur shkollat.

Në udhëzim përfshihen udhëzime në lidhje me planifikimin e kurrikulës në nivel shkolle, me planifikimin e mësimdhënies nga mësuesi dhe me vlerësimin e nxënësve. Të gjitha çështjet e mësipërme janë shoqëruar me shembuj dhe modele sugjeruese.

## 2. PLANI MËSIMOR PËR ARSIMIN E MESËM TË ULËT (AMU)

Plani mësimor është një dokument i rëndësishëm i cili orienton shkollën për organizimin e procesit mësimor, në nivel shkolle, shkalle dhe klase.

Në planin mësimor përcaktohen:

- Fushat e të nxënësve dhe lëndët për secilën shkallë.
- Shpërndarja e lëndëve përgjatë shkallëve.
- Numri i orëve javore për secilën klasë.

Fushat e të nxënësve janë: Gjuhët dhe komunikimi, Matematika, Shkencat e natyrës, Shoqëria dhe mjedisi, Artet, Edukimi fizik, sportet dhe shëndeti, Teknologjia dhe TIK-u. Gjithashtu, në planin mësimor paraqitet edhe shpërndarja e orëve të kurrikulës me zgjedhje. Në tabelën e mëposhtme është pasqyruar vetëm plani i AMU-së, i cili është pjesë e planit të arsimit bazë (klasat 1-9).

### Plani mësimor i AMU- së

Nr.	FUSHA/LËNDËT	KLASAT				GJITHSEJ
		Shkalla 3		Shkalla 4		
		VI	VII	VIII	IX	
<b>1</b>	<b>GJUHËT DHE KOMUNIKIMI</b>	<b>8</b>	<b>8</b>	<b>8</b>	<b>8</b>	<b>32</b>
1.1	GJUHË SHQIPE	5	5	5	5	20
1.2	GJUHË E HUAJ E PARË	3	3	3	3	12
<b>2</b>	<b>MATEMATIKË</b>	<b>4</b>	<b>4</b>	<b>4</b>	<b>4</b>	<b>16</b>
<b>3</b>	<b>SHKENCAT E NATYRËS</b>	<b>2</b>	<b>4</b>	<b>6</b>	<b>6</b>	<b>18</b>
3.1	Fizikë	1	2	2	2	7
3.2	Kimi			2	2	4
3.3	Biologji	1	2	2	2	7
<b>4</b>	<b>SHOQËRIA DHE MJEDISI</b>	<b>3</b>	<b>5</b>	<b>5</b>	<b>5</b>	<b>18</b>
4.1	Qytetari	1	1	1	1	4
4.2	Histori	1	2	2	2	7
4.3	Gjeografi	1	2	2	2	7
<b>5</b>	<b>ARTE</b>	<b>3</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>9</b>
5.1	Muzikë	1	1	1	1	4
5.2	Art pamor	1	1	1	1	4
5.3	Teatër	1				1

<b>6</b>	<b>EDUKIMI FIZIK, SPORTET DHE SHËNDETI</b>	<b>3</b>	<b>3</b>	<b>3</b>	<b>3</b>	<b>12</b>
<b>7</b>	<b>TEKNOLOGJI DHE TIK</b>	<b>2</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>5</b>
7.1	TIK	1	1	1	1	4
7.2	Aftësim teknologjik praktik	1				1
<b>8</b>	<b>KURRIKULA ME ZGJEDHJE</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>8</b>
<b>9</b>	<b>TOTALI</b>	<b>27</b>	<b>29</b>	<b>31</b>	<b>31</b>	

### **Kurrikula me zgjedhje**

Kurrikula me zgjedhje është pjesë e kurrikulës së përgjithshme e cila, në dallim nga kurrikula bërthamë, zgjidhet nga shkolla dhe zhvillohet brenda kohës së planifikuar në planin mësimor në përputhje me interesat, mundësitë, dëshirat, informacionet paraprake të nxënësve dhe me mundësitë e shkollës.

**Kurrikula me zgjedhje në shkallët 3-4 (klasat 6-9)** mund të përdoret:

- Për gjuhën e huaj të dytë (gjuhë frënge, gjuhë gjermane, gjuhë italiane, gjuhë angleze), në përmbushje të interesave të nxënësve për llojin e gjuhës, në varësi të mundësive që ofron shkolla. Programet mësimore të gjuhëve të huaja hartohen në nivel qendror.

OSE:

- Për lëndë, module ose veprimtari të tjera shkollore në funksion të përmbushjes së kompetencave kyçe dhe të realizimit të temave ndërkurrikulare (p.sh., edukimi për të drejtat e njeriut, edukimi mjedisor etj.). Programet mësimore për këto lëndë ose module përgatiten apo përshtaten nga shkolla dhe miratohen në DAR.

Dokumenti i kurrikulës me zgjedhje ka strukturë të njëjtë me atë të kurrikulës bërthamë. Në të përfshihen:

- Rezultatet e të nxënësve të kurrikulës me zgjedhje.
- Udhëzimet metodike për realizimin e saj.
- Ndarja e orëve për kurrikulën me zgjedhje.
- Materialet mësimore dhe burimet e mjetet ndihmëse.
- Vlerësimi i nxënësve.

### **3. PLANIFIKIMI I MËSIMDHËNIES**

Planifikimi është një proces i rëndësishëm i zbatimit të kurrikulës, i cili i krijon mundësinë mësuesit të jetë krijues dhe i lirë në procesin e mësimdhënies. Për një planifikim të mirë, mësuesi duhet të njohë dokumentet e mëposhtme:

- Kornizën Kurrikulare
- Kurrikulën bërthamë
- Programin mësimor

Baza e një planifikimi të suksesshëm është njohja e mirë e programit mësimor. Mësuesi duhet të zbatojë me përpikëri të gjitha kërkesat e këtij programi. Rezultatet e të nxënësve janë një themel i përbashkët për të gjithë mësuesit. Ata përzgjedhin vetë metodat dhe strategjitë më të përshtatshme, burimet e mundshme për t'u shfrytëzuar, llojet dhe mjetet e vlerësimit.

## Llojet e planifikimeve

Planifikimi i mësimdhënies për lëndën ose modulën përfshin:

- Planifikimin vjetor
- Planifikimin për secilën periudhë (shtator-dhjetor; janar-mars; prill-qershor)
- Planifikimin ditor

Në fillim të vitit shkollor mësuesi duhet të dorëzojë pranë drejtorisë së shkollës *planin vjetor* të lëndës ose të modulit, i cili shërben si një kornizë e ndarjes së përgjithshme të përmbajtjes lëndore dhe të orëve mësimore, si edhe *planin e periudhës së parë* (shtator- dhjetor). Planet e periudhës së dytë dhe të tretë dorëzohen para fillimit të secilës periudhë.

Gjatë vitit, sipas rrethanave që i krijohen, mësuesi mund të bëjë ndryshime në planin fillestar mësimor. Mësuesi mund të vendosë të përparojë më ngadalë nga sa e ka parashikuar, kur vë re se nxënësit e tij hasin vështirësi. Në këtë mënyrë mësuesi planifikon duke u bazuar në përparimin e nxënësve dhe në vështirësitë e hasura në periudhat paraardhëse, duke u përqendruar te arritjet e kompetencave kyçe dhe të fushës/ lëndës.

Më poshtë janë dhënë sqarime rreth planeve të mësipërme, për të cilat IZHA ka hartuar disa formate *sugjeruese*.

## Planifikimi vjetor i lëndës

Për planifikimin vjetor të lëndës, mësuesi, përveç programit mësimor duhet edhe të njohë edhe tekstin që ka përzgjedhur për atë vit shkollor. Natyrisht, realizimi i programit është qëllimi i vërtetë i mësuesit, kurse teksti mësimor i përzgjedhur është një mjet për ta përmbushur këtë qëllim. Kur mësuesi sheh se teksti nuk i ka dhënë vendin e mjaftueshëm për vetësimin të një rezultati të nxëni të programit, ai e plotëson vetë këtë mungesë të tekstit, duke përdorur burime të tjera të nxëni.

Plani vjetor është një plan sintetik. Mësuesi planifikon orët dhe përmbajtjen kryesore lëndore për tre periudha. Periudhat janë:

- periudha e parë: shtator- dhjetor;
- periudha e dytë: janar - mars;
- periudha e tretë: prill- qershor.

Formati i planit mësimor vjetor përmban këto rubrika:

TEMATIKAT	SHPËRNDARJA E PËRMBAJTJES LËNDORE		
	SHTATOR – DHJETOR	JANAR – MARS	PRILL – QERSHOR

**Tematika:** Në këtë kolonë, renditen tematikat e programit.

Shënim: Në lëndën e gjuhës shqipe në vend të tematikave, vihen kompetencat lëndore.

**Shpërndarja e përmbajtjes kryesore të lëndës sipas tri periudhave:** Në këtë kolonë vendoset përmbajtja kryesore e lëndës që do të zhvillohet në secilën periudhë dhe për secilën tematikë. Gjithashtu, vendoset edhe totali i orëve për secilën periudhë, ku përfshihen njohuri, projekte, përsëritje, punë laborator, biseda letrare, teste etj., në varësi të specifikave të lëndës.

**Shembull:** Gjeografi, klasa VI

Tematikat	Shpërndarja e përmbajtjes së lëndës		
	Shtator - dhjetor 13 orë	Janar- mars 12 orë	Prill- qershor 10 orë
<p><b>Ndërvarësia midis njerëzve, vendeve, rajoneve dhe mjediseve (35 orë)</b></p> <p><i>Brenda këtyre orëve, duhet të planifikohen dhe orët për teste, projekte, përsëritje.</i></p>	<p><b>Nëntematika: Gjeografia dhe kërkimi gjeografik</b></p> <p>Gjeografia si shkencë; Temat e gjeografisë; Mjetet dhe metodat shkencore të kërkimit gjeografik; Gjeografi dhe roli i tij; Historia e zhvillimeve gjeografike.</p> <p><b>Nëntematika: Hartat gjeografike</b></p> <p>Plani, harta, globi; <i>P.praktike: Ndërtimi i planit të klasës, shkollës; Hartat gjeografike; Llojet dhe përdorimi i tyre; Elementet kryesorë (matematikorë dhe gjeografikë) të hartës; P.Praktike: Përdorimi i shkallës së hartës</i></p>	<p><b>Nëntematika:Hartat gjeografike (vazhdim)</b></p> <p>Vendndodhja gjeografike, absolute dhe relative; Gjerësia dhe gjatësia gjeografike);</p> <p>Koordinatat gjeografike; <i>P.Praktike: Përcaktimi i vendndodhjes absolute në hartë; Harta e Shqipërisë; përshkrimi i itinerarit në hartë; P. Praktike: Përshkrimi i itinerarit në hartë.</i></p> <p><b>Nëntematika:Mjedisi ynë lokal</b></p> <p>Vendndodhja e qytetit/fshatit tim; Mjedisi natyror në qytetin/fshatin tim (relievi, bota bimore she shtazore, burimet ujore etj); Popullsia dhe lëvizjet e saj; <i>P.Praktike: Lëvizjet e popullsisë mbi bazën e të dhënave statistikore.</i></p>	<p><b>Nëntematika:Mjedisi ynë lokal (vazhdim)</b></p> <p>Vendbanimet dhe karakteristikat e tyre, Mënyra e jetesës; Trashëgimia natyrore dhe kulturore e qytetit/fshatit tim; Veprimtaria ekonomike dhe tregtare; <i>P.Praktike: Përcaktimi i vendndodhjes së objekteve në mjedisin lokal; Ndikimi i veprimtarisë njerëzore në mjedis; P.Praktike: Përdorimi i hartës topografike për t'u orientuar në mjedisin lokal.</i></p>

### Planifikimi sipas periudhave

Planifikimi i periudhës është një planifikim më afatshkurtër dhe më i detajuar i mësimdhënies. Ky lloj planifikimi kërkon që mësuesi të përcaktojë me kujdes rezultatet e të nxënësve të kompetencave kyçe dhe rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës/lëndës të cilat do t'i realizojë brenda periudhës, në varësi të cilave përcakton dhe përmbajtjet mësimore që do të zhvillojë gjatë kësaj periudhe, orët mësimore brenda të cilave ato do të realizohen, duke planifikuar paraprakisht situatat e të nxënësve përmes të cilave do të mundësohet zhvillimi i kompetencave, burimet e të nxënësve, metodologjitë e mësimdhënies si dhe llojet e vlerësimit dhe instrumentet vlerësues.

Plani i një periudhe është analitik dhe në të detajohen temat mësimore që do të zhvillohen përgjatë saj. Mësuesi harton planin e periudhës përkatëse në fillim të saj dhe e dorëzon në drejtorinë e shkollës para fillimit të periudhës. Ky plan hartohet duke iu përmbajtur programit dhe tekstit mësimor përkatës.

Në planet sipas periudhave planifikohen të gjitha orët. Mësuesit janë të lirë të bëjnë ndryshimet e tyre hap pas hapi në varësi të specifikave të lëndës së tyre.

### Formati i planit të një periudhe

Formati i planit të një periudhe përmban rubrikat e mëposhtme. Në format janë plotësuar edhe disa shembuj nga lëndë të ndryshme.

Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe (a)						
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave të fushës (b)						
Nr. (c)	Tematika / kapitulli (d)	Temat mësimore (e)	Situata e parashikuara e të nxënësve (f)	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve (g)	Vlerësimi (h)	Burimet (i)
...	...	...	...	P.sh.: diskutim; stuhi mendimi; punë grup; punë në dyshe; hetimi etj.	P.sh.: Vlerësimi i përgjigjeve me gojë. Vlerësimi i punës në grup. Vlerësim mes nxënësish.	P.sh.:teksti i nxënësve; materiale nga interneti; enciklopedi etj.
...	...	...	...			
<i>Shembull (Gjuhë angleze)</i>	<b>Communication</b>	World gestures - reading and vocabulary	Body language			
<i>Shembull (Biologji)</i>	<b>Diversiteti</b>	Mikroorganizmat dhe sëmudjet.	Në kërkim të së padukshmes			
<i>Shembull (Gjuhë shqipe)</i>	<b>Të lexuarit e teksteve</b>	Ditari i një vajze	Ditari im			

	<b>letrare dhe joletrare</b> (kompetencë)					
<i>Shembull (Gjeografia</i> <i>fi</i> .....	<b>Ndërvarësia midis njerëzve, vendeve, rajoneve dhe mjediseve</b>	Gjeografia si shkencë	Historia e zhvillimeve gjeografike			

**a) Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe**

Në këtë rubrikë mësuesi do të vendosë rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe, të cilat do të zhvillohen nga nxënësit përgjatë temave mësimore, të zhvilluara gjatë kësaj periudhe. Mësuesi i përzgjedh këto rezultate në programin mësimor, te rubrika “Rezultatet kryesore të të nxënit, sipas kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së ...”.

**b) Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/ lëndës**

Në këtë rubrikë vendosen rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës, të cilat do të arrihen nga nxënësi nëpërmjet zhvillimit të këtyre temave mësimore. Mësuesi i përzgjedh këto rezultate të nxëni nga programi mësimor. P.sh., *në lëndën e gjuhës shqipe, gjatë periudhës së parë, nga kompetenca “Përdorimi i drejtë i gjuhës” mund të zhvillohen vetëm tema nga morfologjia, prandaj mësuesi do të përzgjedhë vetëm rezultate të nxëni që kanë lidhje me morfologjinë.*

*Nxënësi:*

- *përcakton klasat e fjalëve dhe kategoritë e tyre gramatikore;*
- *dallon mënyrat e formimit të fjalëve në gjuhën shqipe.*

**c) Numri rendor**

Këtu vendosen numrat për temat mësimore. Totali i numrave në planin e periudhës përkon me numrin e orëve që janë përcaktuar në planin vjetor të lëndës ose të modulit.

**d) Tematika/ Kapitulli/ kompetenca**

Në këtë rubrikë shënohen tematikat mbi të cilat është ndërtuar programi i lëndës.

**e) Tema mësimore**

Në këtë rubrikë shënohen të gjitha temat mësimore që do të zhvillohen gjatë periudhës. Mësuesi, përveç temave që i korrespondojnë tekstit mësimor, planifikon edhe orë për projektin, orë për testin ose detyrën përmbledhëse, orë për përmbledhjet ose përsëritjet etj. Gjithashtu, sugjerohet të planifikohen orë për diskutimin dhe vlerësimin e portofolit, në varësi të hapësirës që ka secila lëndë.



#### **f) Situata e të nxënit**

Në këtë rubrikë vendosen situatat e të nxënit që mësuesi parashikon të realizojë gjatë periudhës, të cilat mund të ndryshohen dhe plotësohen përgjatë zhvillimit të lëndës. Situatat e të nxënit mund t'i përkasin një teme mësimore, disa temave mësimore, ashtu sikurse mund të ketë tema mësimore për të cilat mësuesi nuk zhvillon situata të nxëni. Me situatë të nxëni kuptohet ndërtimi i njohurive nëpërmjet një situatë praktike ose reale.

#### **g) Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

Në këtë rubrikë mësuesi vendos teknikat dhe metodat e mësimdhënies (p.sh., harta e konceptit, parashikimi me terma paraprakë, grupet e ekspertëve, punë në grup etj.) që do të përdoren gjatë zhvillimit të këtyre temave në një periudhë të caktuar (jo shumë e detajuar sepse e tillë kjo rubrikë detajohet në planifikimin ditor).

#### **h) Vlerësimi**

Këtu vendosen teknikat e vlerësimit që do të përdoren gjatë zhvillimit të këtyre temave në një periudhë të caktuar si p.sh., vlerësimi i përgjigjeve me gojë; vlerësimi i punës në grup; vlerësim mes nxënësish; vlerësim i aktivitetit gjatë debateve në klasë; vlerësim i detyrave të shtëpisë; vetëvlerësim; intervistë me një listë treguesish; vëzhgim me një listë të plotë treguesish; portofol, prezantim ose punë me gojë ose me shkrim, projekt kurrikular etj. Kjo rubrikë detajohet në planifikimin ditor.

#### **i) Burimet**

Në këtë rubrikë mësuesi vendos burimet që do të përdoren për arritjen e rezultateve të të nxënit si p.sh., teksti i nxënësit, libri digjital, teksti i ushtrimeve (nëse ka të tillë), vepra të ndryshme etj. Kjo rubrikë nuk plotësohet në mënyrë shumë të detajuar, pasi e tillë do të plotësohet në planin ditor.

#### **Planifikimi ditor**

Mësuesi planifikon çdo orë mësimore dhe e hedh këtë në planin e tij ditor. Në përgatitjen e një plani ditor mësuesi duhet të përcaktojë rezultatet e pritshme të asaj ore mësimi, të përgatisë veprimtaritë mësimore, të përzgjedhë metodat dhe strategjitë, të përzgjedhë burimet e të nxënit, të përcaktojë teknikat e vlerësimit të përshtatshme për klasën, të parashikojë punën me klasën, grupet, nxënës të veçantë, të parashikojë lidhjen me lëndët e tjera etj.

#### **Formati i planit ditor**

Më poshtë jepet formati i sugjeruar i një plani ditor:

<b>Fusha:</b>	<b>Lënda:</b>	<b>Shkalla:</b>	<b>Klasa:</b>
<b>Tema mësimore:</b>		<b>Situata e të nxënit:</b>	
<b>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:</b>		<b>Fjalët kyçe:</b>	
<b>Nxënësi:</b>			
-			

<b>Burimet:</b>	<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b>
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b>	
<b>Vlerësimi:</b>	
<b>Detyra:</b>	

- Fusha (përcaktohet fusha e të nxënit ku bën pjesë lënda)
- Lënda (shënohet emri i lëndës)
- Shkalla (shënohet shkalla, duke iu referuar Kornizës Kurrikulare)
- Klasa (shënohet klasa)
- Tema mësimore (shënohet tema mësimore)
- Situata e të nxënit (këtu shkruhet shkurtimisht tema e situatës së të nxënit), nëse mësuesi ka planifikuar një situatë. Nëse mësuesi nuk planifikon situatë për atë temë mësimi, nuk do të shkruajë asgjë në këtë rubrikë.
- Rezultatet e të nxënit (këtu vendosen rezultatet e temës mësimore që nxënësi do të arrijë gjatë orës së mësimi).
- Fjalët ose konceptet kyçe të temës mësimore.
- Burimet që do të përdoren gjatë orës së mësimi.
- Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare, nëse ka.
- Metodologjia ose veprimtarinë e nxënësve (metodologjia për arritjen e rezultateve të të nxënit të orës së mësimi dhe veprimtaritë e nxënësve lidhen me situatën e të nxënit, nëse është planifikuar një e tillë).
- Vlerësimi (shënohen teknikat e vlerësimit).
- Detyrat e shtëpisë (shënohen detyrat e shtëpisë, nëse do të jepen).

### **Shembull 1: Matematikë, klasa VI**

<b>Fusha:</b> Matematikë	<b>Lënda:</b> Matematikë	<b>Shkalla:</b> III	<b>Klasa:</b> VI
<b>Tema mësimore:</b> Fakte të shumëzimit të numrave		<b>Situata e të nxënit:</b> përdorimi i tabelës së shumëzimit për të nxjerrë fakte të shumëzimit	
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave matematikore sipas temës mësimore.</b> <b>Nxënësi në fund të orës së mësimi:</b> - kryen veprimin e shumëzimit; - zbulon fakte të reja dhe i përdor për të kryer shumëzimin.		<b>Fjalët kyçe:</b> shumëzimi, tabela e shumëzimit, fakte të shumëzimit.	
<b>Burimet:</b> letër me katrorë për tabelën e shumëzimit, lapsat me ngjyrë,		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Arti pamor (përdorimi i ngjyrave)	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b>			

### Organizimi i orës së mësimi:

**Parashikimi i njohurive:** Nxënësit punojnë në dyshe. Njëri prej nxënësve krijon shumëzime dhe ia jep shokut që të gjej rezultatin duke i kontrolluar ato dhe më pas këmbehen me njëri -tjetrin. P.sh.,  $20 \times 7$ ;  $80 \times 4$ ;  $90 \times 7$ ;  $30 \times 6$ ;  $5 \times 40$ ;  $9 \times 80$  etj. Disa prej dysheve të nxënësve diskutojnë ushtrimet e tyre dhe rezultatet përkatëse.

**Ndërtimi i njohurive:** Dyshet e nxënësve kanë përpara një letër me katrorë ku kanë shënuar tabelën e shumëzimit  $10 \times 10$ . Nxënësit ngjyrosin me laps të kuq të gjitha prodhimet e njëjta. P.sh., numri 56 është  $7 \times 8$  edhe  $8 \times 7$ . Ata shkruajnë në fletore vetinë që zbulojnë lidhur me këtë fakt.


Më pas ngjyrosin me laps jeshil të gjitha prodhimet e numrave që shumëzohen me 1. Shkruajnë përsëri në fletore vetinë përkatëse. Më pas ngjyrosin me laps blu të gjitha numrat në tabelë që janë prodhim i një numri me 10. Shkruajnë faktin përkatës që zbulojnë për këto prodhime. Me ngjyrë bojë qielli ngjyrosin prodhimet e numrave që shumëzohen me 5 duke zbuluar një fakt që lidhet me shumëzimin e numrave me 10. Më pas ngjyrosin me laps portokalli prodhimet e numrave që shumëzohen me 2 duke shkruar faktin e zbuluar dhe e lidhin atë me faktin e shumëzimit me numrin 4.

Mësuesja diskuton pyetjen: Çfarë ndodh kur shumëzojmë me 10, 100, 1000?

Nxënësit bëjnë një hartë konceptesh duke përmbledhur vetitë dhe faktet e shumëzimit të numrave. Kjo tabelë diskutohet dhe plotësohet nga të gjithë nxënësit.



Mësuesja vizaton në tabelë një skemë, e cila plotësohet nga nxënësit. Dyshet e nxënësve vendosin në rrahë, numra dhe në kuti gjejnë prodhimin e tyre. Si në shembullin më poshtë:



Nxënësit përgatisin 3 skema të tilla duke vendosur numra të ndryshëm dhe duke kryer veprimet.

Më pas mësuesja paraqet një situatë problemore. Era lexon 11 faqe në ditë. Era llogariti që librin e saj prej 440 faqesh e mbaroi për 40 ditë. Përdorni faktet e shumëzimit me 10 dhe shumëzimit me 1 për të llogaritur dhe argumentuar përgjigjen e saj. Sa faqe lexon ajo në 10 ditë? Po në 30 ditë?

**Përforcimi i të nxënit:** Mësuesi ju kërkon nxënësve të krijojnë një situatë problemore të ngjashme. Nxënësit punojnë në dyshe dhe diskutojnë situatën e krijuar prej tyre.

**Vlerësimi:** Mësuesi përdor teknikën e vlerësimit të nxënësit nga nxënësi. Mësuesi mban shënime në evidencë për disa prej nxënësve lidhur me kryerjen e veprimeve të shumëzimit, zbulimin dhe argumentimin e fakteve të shumëzimit, për krijimin e situatave problemore, apo edhe për përmbledhjen e vetive dhe fakteve të shumëzimit.

**Detyra:** Mësuesi orienton nxënësit për plotësimin e skemave të tjera si në shembullin më sipër. Ata mund të krijojnë skema të tjera për të kryer veprimin e shumëzimit.

## Shembull 2: Gjuhë shqipe, klasa VI

<b>Fusha:</b> Gjuhët dhe komunikimi	<b>Lënda:</b> Gjuhë shqipe	<b>Shkalla:</b> III	<b>Klasa:</b> VI
<b>Tema mësimore:</b> Mitrush Kuteli “Fuqia e Mujit”, <i>ora e parë</i> <b>Shënim:</b> Ky tekst mund të punohet 2-3 orë mësimi.		<b>Situata e të nxënit:</b> Këngët tona legjendare	
<b>Rezultatet e të nxënit</b> Nxënësi: - tregon brendinë e tekstit duke u përqendruar në pjesët kryesore; - rendit në radhë ngjarjet kryesore të tekstit; - analizon figurën e Mujit dhe të zanave; - lidh jetën dhe përvojat e tij me ato të personazheve; - shpreh dhe argumenton pëlqimet e tij për tekstin që lexon.		<b>Fjalët kyçe:</b> këngë legjendare, Cikli i Kreshnikëve, Muji, Halili, zanat.	
<b>Burimet:</b> Teksti i nxënësit, foto dhe ilustrime nga Cikli i Kreshnikëve.		<b>Lidhja me fushat/lëndët e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Arti pamor, Histori.	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b>			
<b>Organizimi i orës së mësimi:</b> <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (stuhi mendimi)</b> Mësuesi i pyet nxënësit rreth njohurive të tyre dhe rreth informacionit të mbledhur për Ciklin e Kreshnikëve - Çfarë janë këngët legjendare? Keni lexuar ndonjë të tillë? - Për çfarë flet Cikli i Kreshnikëve? - Cilët janë personazhet e këtij cikli?			

- Për çfarë luftojnë Muji dhe Halili?

### **Ndërtimi i njohurive të reja**

#### **a) Prezantim i disa fotove për nxitjen e imagjinatës së nxënësve**

Mësuesi prezanton disa foto nga Cikli i Kreshnikëve dhe kërkon nga nxënësit përshtypjet e tyre

- Ç'përshtypje ju bëjnë këto foto?
- Si portretizohet Muji? Çfarë ju pëlqen më shumë te ai?
- Po zanat?

#### **b) Prezantimi i pjesës së re**

Mësuesi zhvillon një bisedë hyrëse në të cilën prezanton titullin e pjesës, autorin (Mitrush Kutelin) dhe përpjekjet dhe vlerat e tij në përshtatjen e disa këngëve të Ciklit të Kreshnikëve në prozë, në vëllimin “Tregime të moçme shqiptare”.

#### **c) Parashikim me terma paraprakë**

Mësuesi prezanton para nxënësve 6 fjalë kyçe dhe kërkon nga nxënësit të krijojnë një histori me to (nxënësit mund të punojnë edhe në grupe). Fjalët kyç janë: Muji, foshnja, përkund, Zana, gji, fuqi, ëndërr.

Nxënësit prezantojnë punët e tyre.

#### **d) Kuptimi i tekstit**

##### **→ Lexim i pjesës nga nxënësit**

Nxënësit lexojnë me kujdes tekstin. Mësuesi i udhëzon që nxënësit të nënvizojnë fjalët që nuk ua dinë kuptimin dhe janë të panjohura për ta. Më pas mësuesi sqaron kuptimin e tyre dhe kërkon nga nxënësit të ndërtojnë fjali me to (bjeshkë, kullotë, mritz, nginj etj.).

##### **→ Pyetje rreth brendisë së tekstit**

Mësuesi pyet ose nxit nxënësit të bëjnë pyetje:

- Çfarë ndodhi pas mesnate?
- Çfarë po bënte Muji?
- Si e pritën zanat përkujdesjen e Mujit ndaj foshnjave?
- Çfarë u kërkoi Muji zanave?
- Sa fuqi merr Muji prej zanave?
- Si përfundon kjo ngjarje? A ishte në ëndërr Muji?

**Shënim:** Çdo përgjigje duhet shoqëruar me ilustrime nga teksti (fragmenti).

##### **→ Rendi i ngjarjeve të tekstit**

Mësuesi kërkon nga nxënësit që të vendosin një numër përbri çdo ngjarjeje në tekst.

#### **e) Interpretimi dhe vlerësimi**

##### **→ Analizë personazhesh**

Sa personazhe prezantohen në këtë tekst? Cilët janë ata?

##### **Muji**

- Cili është personazhi kryesor në këtë tekst?
- Çfarë është Muji?
- Ku duket mirësia e tij?
- Pse Muji zgjedh t'u kërkojë fuqi zanave?
- A e vlerëson Muji ndihmën e zanave? Çfarë u ofron në këmbim atyre?
- Si do të vepronit ju në vend të Mujit? Çfarë do t'u kërkonit zanave? Pse?

##### **Zanat**

- Si përshkruhen zanat në këtë tekst?

- Janë krijesa reale apo imagjinare?
- Si i imagjinoni ju ato?
- Si mendoni ju, pse zanat i kishin lënë foshnjat? Kishin punë apo për të provuar Mujin? (e dyta) Ku duket kjo/ (kur thonë që e njohin Mujin dhe se ndihmojnë njerëzit e mirë)

### **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura**

#### → **Ditaret e të nxënësve**

Mësuesi fton nxënësit që në një fletë fletoreje të ndarë me një vizë në mes. Në njërën anë ata mund të shkruajnë ndonjë pjesë, fjali ose shprehje që ju pëlqen më shumë dhe në anën tjetër mund të shkruajnë një koment ose një arsye pse ju pëlqen. Më pas nxënësit prezantojnë gjetjet ose shënimet e tyre.

**Vlerësimi:** Mësuesi mban shënime në evidencë për disa nxënës që demonstron njohuri rreth Ciklit të Kreshnikëve, aftësi për të kuptuar dhe për të interpretuar tekstin e Mitrush Kutelit, si dhe për të analizuar personazhet e tekstit.

**Detyrë shtëpie:** Përshkruani personazhin e Mujit, duke u ndalur te pamja e tij e jashtme.

## **4. VLERËSIMI I NXËNËSIT**

Vlerësimi i nxënësve është ndër komponentët më të rëndësishëm të kurrikulës me bazë kompetencat. Ky vlerësim, bazuar në rezultatet e të nxënësve, përfshin gjykimin për arritjet e nxënësve (njohuri, shkathtësi, qëndrime) përkundrejt niveleve të arritjeve.

Mësuesi, në përputhje me parimet themelore të vlerësimit, siguron përdorimin e të gjitha llojeve të vlerësimit, të cilat përcaktohen si të domosdoshme për të gjykuar në lidhje me arritjet e nxënësve, në funksion të mbështetjes së të nxënësve dhe mësimdhënies.

Paketa e dokumenteve për vlerësimin përfshin:

- Kornizën e vlerësimit të nxënësve për arsimin parauniversitar (MAS, Nr. 5563, dt, 23.07.2015)
- Udhëzimin e MAS-it, nr. 34, datë 11.09.2015 “Për vlerësimin e nxënësve për kurrikulën me kompetenca në arsimin bazë”.
- Nivelet e arritjeve të nxënësve për vlerësimin e kompetencave, shkallët 3-4 (klasat 6-9).
- Formatet sugjeruese të evidencave për vlerësimin e vazhduar.

### **Vlerësimi për të nxënësit kryhet nëpërmjet:**

- vlerësimin të vazhduar;
- vlerësimin me test/detyrë përmbledhëse;
- vlerësimin të portofolit lëndor të nxënësve.

### **Vlerësimi i vazhduar**

- Vlerësimi i vazhduar bazohet në vëzhgimet dhe gjykimet e mësuesit mbi *përgjigjet me gojë ose me shkrim, punët me shkrim, punët në grup, diskutimet e mësuesit me nxënësit, vetëvlerësimin e nxënësve, vlerësimin e nxënësve nga nxënësi, pjesëmarrjen në aktivitete dhe debatet në klasë, vlerësimin e detyrave të shtëpisë apo të klasës*, përgjatë një periudhe.
- Për vlerësimin e vazhduar të arritjes së rezultateve të të nxënësve, mësuesi **mban shënime në evidencë për çdo nxënësi**. Shënimet në evidencë mund të mbahen me **notë, simbole**

etj., të shoqëruara me **komente** të cilat i referohen niveleve të arritjes së kompetencave lëndore.

- Për lehtësimin e punës së tij mësuesit i sugjerohet të shkruajë në fund të evidencës **një legjendë** e cila shpjegon kuptimin e simboleve të vendosura.
- Komentet i referohen **niveleve të arritjes së kompetencave lëndore** bazuar në dokumentin përkatës të “Niveleve të arritjes” shkallët 3-4 (klasat 6-9).
- Në shtojcë sugjerohen **dy formate të evidencave** për mbajtjen e shënimeve. Mësuesi është i lirë të përshtasë formatin e evidencës, në varësi të specifikave të lëndës ose të krijojë një formë tjetër të mbajtjes së shënimeve, duke ruajtur pjesën përmbajtësore të saj.
- **Evidenca** dorëzohet në drejtori në përfundim të periudhës dhe ruhet deri në përfundim të vitit shkollor. Ajo është objekt monitorimi dhe inspektimi.

Më poshtë jepen disa shembuj për një nxënës të vlerësuar në lëndët:

**Shembull 1: Matematikë (klasa VII)**

**Periudha:** shtator - dhjetor

Nr.	Nxënësi / Data	30.09	14.10	31.10	9.11	25.11	19.12	Komentet janë: Nivelet e arritjes për njohurinë/konceptin përkatës
1	Ilir Shkëmbi	+-						N3. SHVP
			✓					N3. Drejtëza paralele, pingule, prerëse
				9				TN
					+			N4. Katrori i numrave deri në 20
						9		N4. Sistemi 12 dhe 24 orësh
							10	N4. Këndet e kundërt në kulm

*Legjendë: ++ (sh. mirë); + (mirë); +- dhe ✓ (mesatar); -+ dhe ? (nën mesatar); - dobët; - - (sh. dobët). N1- Niveli 1; N2 – Niveli 2; N3 – Niveli 3; N4 – Niveli 4. TN – test i ndërmjetëm*

*Në përfundim të periudhës tremujore, vlerësimi i vazhduar mbyllet me një notë përmbledhëse (NVv). Nota e vlerësimit të vazhduar në këtë rast gjykohet në bazë të ecurisë (progresit ose regresit) të arritjeve të nxënësit përgjatë periudhës, pra NVv është 9. Në shembullin e mësipërm ecuria e nxënësit është progresive, por mund të jetë edhe regressive.*

## Shembull 2: Muzikë

**Periudha:** shtator - dhjetor

<i>Nr.</i>	<i>Nxënësi / Data</i>	<i>28.09</i>	<i>3.10</i>	<i>31.10</i>	<i>9.11</i>	<i>25.11</i>	<i>KOMENTE</i>	
<i>1</i>	<i>Ani Grillo</i>	<i>+-</i>					<i>N3. Ritmi 2/4</i>	
			<i>✓</i>				<i>N3. Kënga “Gabimi i Mirelës”</i>	
				<i>9</i>			<i>N4. Intervalet</i>	
						<i>10</i>		<i>N4. Ushtrime ritmike dhe melodike</i>
							<i>+</i>	<i>N4. Ritmi 4/4</i>

### Vlerësimi me test ose detyrë përmbledhëse

- Në përfundim të periudhës kryhet vlerësimi me test ose detyrë përmbledhëse, e cila ka për qëllim të matë nivelin e arritjeve të nxënësit për një grup të caktuar rezultatesh të nxëni.
- Mësuesi përzgjedh të zhvillojë test ose detyrë përmbledhëse, në varësi të veçorive të lëndës.
- Testi përmbledhës është test që përmban vetëm rezultatet e të nxënit (njohuritë dhe shkathtësitë) kryesore të periudhës përkatëse. Koha e realizimit të testit është 45 min si të gjitha testet e tjera.
- Në përfundim të periudhës, për të lehtësuar nxënësit, drejtoria e shkollës organizon punën që të kryejë shpërndarjen e zhvillimit të testeve ose detyrave përmbledhëse në ditë të ndryshme.
- Nëse drejtoria ka planifikuar të realizojë teste në lëndë të caktuara mund t’i zhvillojë ato në përputhje me testet ose detyrat përmbledhëse.
- Për disa lëndë si: Qytetari; Art pamor; Muzikë; Teatër; Edukim fizik, sporte dhe shëndet etj., në fund të periudhës mund të zhvillohet detyrë përmbledhëse. P.sh., në lëndën e muzikës mund të realizohen këto detyra përmbledhëse: një kërkim mbi jetën dhe veprën e një kompozitori të preferuar shqiptar apo të huaj ose krijime individuale lidhur me *ritmet e thjeshta* 2/4, 3/4, 4/4.

### Vlerësimi me portofol lëndor

- Portofoli është koleksionim sistematik i detyrave dhe punimeve krijuese dhe hulumtuese të kryera nga nxënësi përgjatë periudhës për të dëshmuar zhvillimin e kompetencave (njohurive, shkathtësive, qëndrimeve).
- Mësuesi udhëzon nxënësit për krijimin e portofolit dhe bashkëpunon me ta rreth përmbajtjes së tij. Në fillim të periudhës, mësuesi në bashkëpunim me nxënësit,



përcaktojnë detyrat dhe punimet që do të përfshijnë në portofol përgjatë periudhës, në varësi të specifikave të lëndës.

- Këto detyra zhvillohen gjatë periudhës dhe nuk janë pjesë e vlerësimit të vazhduar (në evidencë), por vetëm pjesë e portofolit lëndor. Sugjerohet që përgjatë një periudhe, të përfshihen në portofol, të paktën 3 detyra të nxënësit, përfshirë projektin ose një nga fazat e tij.
- Pjesë e portofolit është edhe projekti kurrikular. Projekti kurrikular mund të jetë i shtrirë vetëm brenda një periudhe, por mund të jetë i shtrirë (nëse është një) edhe përgjatë gjithë vitit.
- Sido që të jetë shtrirja e projektit ai ka vlerësimin e tij brenda vlerësimit të portofolit. Nëse projekti ka shtrirje përgjatë gjithë vitit, në çdo periudhë vlerësohet si pjesë e portofolit ajo pjesë e projektit që është realizuar. Në rastin kur ka shtrirje brenda një periudhe vlerësohet i gjithë projekti.
- Për vlerësimin e portofolit, mësuesi përcakton kritere të qarta dhe ua komunikon nxënësve. Vlerësimi i detyrave të portofolit varet nga pesha që secili mësues i vendos secilës detyrë.
- Rubrikat e portofolit mund të grupohen në:
  - punë dhe detyra të kryera në klasë dhe jashtë saj, si punë praktike, punë laborator, ese, detyrë me shkrim etj.;
  - projekte individuale ose në grup;
  - detyra dhe kontribute të pavarura të nxënësit, të cilat janë dëshmi e talentit, e hulumtimeve praktike, e punëve tematike (me shkrim, audio-vizuale etj.).
- Vlerësimi i portofolit mund të planifikohet në planin e periudhave si orë e veçantë (në fund ose përgjatë periudhës) ose mund të realizohet përgjatë tre - katër orëve mësimore të fundit të periudhës. Në këtë rast mësuesi përcakton një grafik të nxënësve të cilëve do t'u vlerësohet portofoli.

### **Shembull i vlerësimit të portofolit në lëndën e matematikës**

Në lëndën e matematikës, mësuesi mund të planifikojë të paktën 3 detyra për portofolin lëndor (përfshirë edhe projektin kurrikular). Në shembullin më poshtë, mësuesi, në bashkëpunim me nxënësit, ka përcaktuar 4 detyra për portofolin e periudhës së parë, i cili do të ketë gjithsej 50 pikë. Për vlerësimin e portofolit mësuesi **përcakton vetë** pikët/peshat për secilën detyrë. (Më poshtë është dhënë thjesht një shembull, pikët/peshat e të cilit shërbejnë për të ilustruar modelin dhe mund të mos përdoren domosdoshmërisht nga mësuesi).

- a. Hulumtim mbi rregullën e përdorimit të gishtave të dorës për shumëzimin e numrave me 9 ose Hulumtim mbi përdorimin e numrave me shenjë në situata të jetës reale (p.sh., në anije kozmike, niveli i detit etj.). (10 pikë)
- b. Krijimi i shprehjeve algjebrike nga situata të jetës reale (psh, shpejtësia dhe koha në gara të makinave të F1 etj.) apo fotografi, pamje të figurave ose vizatime me drejtëza simetrie (10 pikë)
- c. Projekti (faza e parë) Përcaktimi i temës së studimit dhe hartimi i pyetësorit – punë grupi. (20 pikë)

- d. Krijimi i një situatë praktike me përdorimin e përqindjes në uljen e çmimeve dhe ofertave të ndryshme etj. ose krijimi i një recete gatimi duke përdorur raportet dhe përpjesëtimin. (10 pikë)

Vlerësimi me pikë

Detyra	Detyra 1	Detyra 2	Detyra 3	Detyra 4	Portofoli
Nota	7 pikë	10 pikë	17 pikë	8 pikë	42 pikë

Sipas tabelës së vlerësimit me notë (si rasti i testeve), vlerësimi i këtij portofoli është nota 9 (nëntë).

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	>14	14-20	21-26	27 - 32	33-38	39-44	45-50

### Shembull i vlerësimit të portofolit në lëndën e gjuhës shqipe

Në lëndën e gjuhës, mësuesi mund të planifikojë të paktën 3 (tri) detyra për portofolin lëndor (përfshirë edhe projektin kurrikular). Në shembullin më poshtë, mësuesi, në bashkëpunim me nxënësit, ka përcaktuar e detyra për portofolin e periudhës së parë, i cili do të ketë gjithsej 50 pikë. Për vlerësimin e portofolit mësuesi **përcakton vetë** pikët/peshat për secilën detyrë. Më poshtë është dhënë **thjesht një shembull**, pikët/peshat e të cilit shërbejnë për të ilustruar modelin dhe mund të mos përdoren domosdoshmërisht nga mësuesi).

- Përshkruani ngjashmëritë dhe dallimet mes jush dhe një personazhi të pëlqyer nga ju. (10 pikë)
- Projekti “Përgatitja e një reviste për fëmijë” (faza e parë). Përzgjedhja e rubrikave dhe mbledhja e informacionit kryesor. (20 pikë)
- Gjetja e rasteve të përdorimit të gabuar të shkronjës së madhe në jetën e përditshme, si p.sh., në menu, në tabela të ndryshme, në televizion, në libra etj. (20 pikë)

Vlerësimi me pikë

Detyra	Detyra 1	Detyra 2	Detyra 3	Portofoli
Nota	8 pikë	14 pikë	14 pikë	36 pikë

Sipas tabelës së vlerësimit me notë (si në rastin e vlerësimit të testeve), vlerësimi i këtij portofoli është nota 8 (tetë).

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	>14	14-20	21-26	27 - 32	33-38	39-44	45-50

## Vlerësimi periodik

Vlerësimi periodik bëhet në përfundim çdo periudhe dhe përmban tri nota:

- *Nota e vlerësimit të vazhdueshëm (NV<sub>v</sub>)*, e cila vendoset në regjistër në kolonën përkatëse në faqet e vlerësimit.
- *Nota e vlerësimit me test ose me detyrë përmbledhëse (NT<sub>p</sub>)*, e cila vendoset në regjistër në kolonën përkatëse në faqet e vlerësimit.
- *Nota e vlerësimit të portofolit lëndor (NV<sub>p</sub>)*, e cila vendoset në regjistër në kolonën përkatëse në faqet e vlerësimit.

## Vlerësimi përfundimtar

Vlerësimi përfundimtar shënohet në regjistër duke plotësuar kolonat “Vlerësimi vjetor” dhe në kolonën “Nota përfundimtare”.

Vlerësimet vjetore përmbajnë:

- *Notën vjetore të vlerësimit të vazhduar* që është rezultat i tri periudhave.
- *Notën vjetore të vlerësimit me test ose detyrë përmbledhëse* që është rezultat i tri periudhave.
- *Notën vjetore të vlerësimit të dosjes së nxënësit* që është rezultat i tri periudhave.

**Në rast kur ecuria e nxënësit është e dukshme progresive ose regresive gjatë dy periudhave të fundit, vlerësimi i tij vjetor në secilën nga rubrikat mund të jetë progresiv ose regresiv.** Në rast kur ecuria e tij nuk është e qëndrueshme përgjatë tri periudhave, atëherë vlerësimi llogaritet me mesatare.

**Nota përfundimtare** llogaritet me përqindje për secilën nga rubrikat

**Tabela:** Pesha në përqindje e llojeve të vlerësimit

Lloji i vlerësimit	Pesha në përqindje
Vlerësimi i vazhdueshëm	40%
Vlerësimi me test ose detyrë përmbledhëse	40%
Vlerësimi i portofolit të nxënësit	20%

Hapat për njehsimin e notës përfundimtare janë:

- Përcaktohet nota vjetore e vlerësimit të vazhduar (NV<sub>v</sub>), bazuar në tre notat e periudhave, duke gjykuar në mënyrë progresive.
- Përcaktohet nota vjetore e testit/detyrës përmbledhëse (NT<sub>p</sub>) bazuar në tre notat e periudhave, duke gjykuar në mënyrë progresive.
- Përcaktohet nota vjetore e portofolit të nxënësit (NV<sub>p</sub>) bazuar në tre notat e periudhave, duke gjykuar në mënyrë progresive.
- Shumëzohet secila prej notave me përqindjen përkatëse.
- Mblidhen këto prodhime dhe shuma rrumbullakoset me numër të plotë (p.sh., 8,8 ≈ 9).

$$(NV_v \times 0.4) + (NT_p \times 0.4) + (NV_p \times 0.2) = \text{Nota përfundimtare}$$

- **Përshkrimi i notës përfundimtare vjetore argumenton** nivelin e arritjeve të kompetencave të fushës/lëndës. Përshkrimi i referohet pikave më të forta që ka nxënësi lidhur me përmbushjen e kompetencave të lëndës

**Shembull 1:** Gjeografi, klasa VI

Tremujori I			Tremujori II			Tremujori III			Notat vjetore			Nota përfundimtare
NV V	NT <sub>P</sub>	NVP	NV V	NT <sub>P</sub>	NVP	NV V	NT <sub>P</sub>	NVP	NV V	NT <sub>P</sub>	NVP	
8	7	8	7	7	8	8	7	8	8	7	8	8

$$(8 \times 0.4) + (7 \times 0.4) + (8 \times 0.2) = 7.6$$

**Nota përfundimtare 8**

Nota përfundimtare	Përshkrimi i vlerësimit
8	Identifikon dhe përdor disa prej koncepteve që lidhen me temat bazë të gjeografisë, kërkimin gjeografik dhe mjedisin lokal, në situata mësimore. Përdor me ndihmë mjetet gjeografike (harta, globin, fotografi ajrore, imazhe satelitore etj.), si mjete për lokalizimin e vendndodhjes së tipareve dhe dukurive fiziko-gjeografike e humane. Identifikon dhe përshkruan pasoja të ndërveprimit të veprimtarisë njerëzore në mjedisin gjeografik lokal dhe anasjelltas, duke përdorur shembuj të gatshëm.

**Shembull 2:** Muzikë, klasa VI

Periudha I			Periudha II			Periudha III			Notat vjetore			Nota përfundimtare
NV V	NT <sub>P</sub>	NV P	NV V	NT <sub>P</sub>	NV P	NV V	NT <sub>P</sub>	NV P	NV V	NT <sub>P</sub>	NVP	
7	8	9	9	8	10	9	9	10	9	8	10	9

$$(9 \times 0.4) + (8 \times 0.4) + (10 \times 0.2) = 8.8$$

### Nota përfundimtare 9

Nota përfundimtare	Përshkrimi i vlerësimit
9	Ani ... këndon dhe interpreton me korrektësi këngë të ndryshme për fëmijë dhe popullore në ritme të thjeshta dhe të përziera muzikore, duke respektuar rregullat e këndimit dhe interpretimit. Njeh dhe shpjegon duke sjellë shembuj muzikore të muzikës popullore duke ritmizuar dhe kënduar ato me saktësi.

### Shembull 2: Gjuhë shqipe, klasa VII

Tremujori I			Tremujori II			Tremujori III			Notat vjetore			Nota përfundimtare
NV V	NT <sub>P</sub>	NV P	NV V	NT <sub>P</sub>	NV P	NV V	NT <sub>P</sub>	NV P	NV V	NT <sub>P</sub>	NV P	8
7	6	7	8	7	8	8	7	9	8	7	8	

$$(8 \times 0.4) + (7 \times 0.4) + (8 \times 0.2) = 7.6$$

### Nota përfundimtare 8

Nota përfundimtare	Përshkrimi i vlerësimit
8	Arbri... kupton, interpreton, analizon mirë tekste të ndryshme letrare dhe joletrare, si dhe jep disa gjykime rreth tyre. Nxënësi shkruan duke u përqendruar në temën që do të trajtojë dhe lidh mirë fjalitë në paragraf e paragrafët mes tyre. Ai përdor mirë gjuhën standarde dhe zbaton rregullat gramatikore e drejtshkrimore.

### Vlerësimi i nxënësit për zhvillimin e kompetencave kyçe

- Vlerësimi i nxënësit për kompetencat kyçe bazohet në rezultatet e të nxënësit të kompetencave kyçe për shkallën përkatëse.
- Vlerësimi i nxënësit për kompetencat kyçe realizohet nga mësuesi kujdestar në bashkëpunim me mësuesit e të gjitha lëndëve.

### Shembull: Vlerësimi i kompetencave kyçe

<b>Nxënësi</b>	<b><i>Vlerësimi i nxënësit për realizimin e kompetencave kyçe</i></b>
<b>Arbër...</b>	Arbri shpreh gjithmonë mendimet e tij rreth temave të ndryshme, me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit. Ai përdor programe të përshtatshme kompjuterike për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave në fusha të ndryshme të dijes. Arbri përfshihet aktivisht në projekte ose punë në grup që janë të rëndësishme për shkollën. Ai zbaton dhe respekton me korrektësi rregullat e mirësjelljes dhe mban qëndrim kritik ndaj nxënësve që nuk i respektojnë ato.

<b>Nxënësi</b>	<b><i>Vlerësimi i nxënësit për realizimin e kompetencave kyçe</i></b>
<b>Elira...</b>	Elira..tregon përgjegjësi të lartë për kryerjen e detyrave gjatë procesit mësimor. Ajo komunikon lirshëm me një fjalor të pasur shkencor, si dhe debaton në mënyrë kritike për situata të ndryshme problemore. Ndërton marrëdhënie të shëndetshme me shokët e klasës dhe dallohet në punët në grup. Elira dallohet për aftësitë e saj në përdorimin e teknologjisë, me synim thellimin e njohurive dhe realizimin e projekteve.

## SHTOJCË 1: Formate planifikimi

### Plani mësimor vjetor

**Klasa:** .....

**Fusha:** .....

**Lënda:** .....

Tematikat	Shpërndarja e përmbajtjes së lëndës		
	Shtator – dhjetor Orët ..... Në këtë kolonë vendoset përmbajtja e lëndës që do të zhvillohet në këtë periudhë për secilën tematikë	Janar – mars Orët ..... Në këtë kolonë vendoset përmbajtja e lëndës që do të zhvillohet në këtë periudhë për secilën tematikë	Prill – qershor Orët..... Në këtë kolonë vendoset përmbajtja e lëndës që do të zhvillohet në këtë periudhë për secilën tematikë
<i>Këtu vendosen orët e planifikuara për secilën tematikë për klasën e ____, të marra nga programi i shkallës</i>			

### Planifikimi sipas periudhave

**Fusha:** .....

**Lënda:** .....

<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b> ..... <i>Këtu vendosen rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe, të cilat do të arrihen nga nxënësi nëpërmjet zhvillimit të këtyre temave mësimore</i>
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</b> ..... <i>Këtu vendosen rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës, të cilat do të arrihen nga nxënësi nëpërmjet zhvillimit të këtyre temave mësimore</i>

<b>Nr.</b>	<b>Tematika (orë)</b>	<b>Temat mësimore</b>	<b>Situatë e parashikuar e të nxënit</b>	<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b>	<b>Vlerësimi</b>	<b>Burimet</b>
		<i>Këtu vendosen temat mësimore për çdo orë mësimi.</i>	<i>Këtu vendoset situata të nxënësi që mësuesi parashikon të realizojë gjatë një ose disa temave mësimore.</i>	<i>Këtu vendoset metodologjia e mësimdhënies që do të përdoret gjatë zhvillimit të këtyre temave (jo shumë e detajuar sepse vendoset në planifikimin ditor).</i>	<i>Këtu vendosen teknikat e vlerësimit të arritjeve të nxënësit (jo shumë e detajuar sepse vendoset në planifikimin ditor).</i>	<i>Këtu vendosen burimet që përdor mësuesi dhe nxënësi për arritjen e rezultateve të nxënies. (jo shumë e detajuar sepse vendoset në planifikimin ditor).</i>

### Planifikimi i orës mësimore

<b>Tema mësimore:</b>	<b>Situata e të nxënit:</b>
<b>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:</b>	<b>Fjalët kyçe:</b>
<b>Burimet:</b>	<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b>
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b>	
Organizimi i orës së mësimi, i cili mund të përmbajë: <ul style="list-style-type: none"> <li>- lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve;</li> <li>- ndërtimin e njohurive të reja;</li> <li>- prezantimin dhe demonstrimin e rezultateve të arritura etj.</li> </ul>	
<b>Vlerësimi:</b> Pjesë e vlerësimit është edhe përcaktimi i nxënësve që do të vëzhgohen gjatë kësaj ore mësimi duke pasur parasysh të dhënat e mbledhura në evidenca e progresit të tij.	
<b>Detyrat dhe puna e pavarur:</b> Detyrat dhe puna e pavarur të planifikohen në mënyrë të tillë që të mos rrisin ngarkesën e nxënësit. Mundësisht sipas rastit të jenë të integruara brenda fushës apo ndërmjet fushave.	



## SHTOJCË 2: Modele evidencash

29.07.2015 Evidence per vleresimin - Word

FILE HOME INSERT DESIGN PAGE LAYOUT REFERENCES MAILINGS REVIEW VIEW MathType Foxit PDF

Clipboard Font Paragraph Styles Editing

29.07.2015 Evidence per vleresimin - Word

EVIDENCA TREMUJORE PER MBAJTJEN E VLERESIMEVE TE NXENENSVE

KLASA X- TREMUJORI .....

Nr	Emri Mbiemër	Muajt/Datë:	Komente
1			
2			
3			
4			
5			

*Shënim: Ky format llogaritet në A3, si rrjedhim numri i nxënësve është më i madh. Në lëndë mund të ketë një ose dy fletë (nëq të dyja faqet). Në varësi të lëndës mund të llogaritet edhe numri i vlerësimeve.*

PAGE 1 OF 2 63 WORDS ENGLISH (UNITED KINGDOM)

10:53 28/09/2016

Evidenca formati 2 09.09.2016 - Excel

FILE HOME INSERT PAGE LAYOUT FORMULAS DATA REVIEW VIEW Foxit PDF

Clipboard Font Alignment Number Styles Cells Editing

E10

EVIDENCA TREMUJORE PER MBAITIEN E VLERESIMEVE TE NXENENSVE										KLASA																			
Nr.	Nxenesi / Data	KOMENTE								Nr.	Nxenesi / Data	KOMENTE								Nr.	Nxenesi / Data	KOMENTE							
1										10										19									
2										11										20									
3										12										21									
4										13										22									
5										14										23									
6										15										24									
7										16										25									
8										17										26									
9										18										27									
10										19										28									
11										20										29									
12										21										30									
13										22										31									
14										23										32									
15										24										33									
16										25										34									
17										26										35									
18										27										36									
19										28										37									
20										29										38									

Sheet1 Sheet2 Sheet3

READY 10:54 28/09/2016

## Kujtesë

Për çdo paqartësi ose pyetje mund të shkruani në adresën e email-it:  
 sekretaria@izha.edu.al